



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602293/5

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandohet mundësimi i dorëzimit sa më parë i shpërblimit, për pasurinë e shpronësuar të ndjerit V.T, regjistruar me nr.6/26, ZK 8533, të regjistrit të ZVRPP, Fier.*

Drejtuar : **Armando Subashi**
Kryetar i Bashkisë

FIER

I nderuar Z.Kryetar!

Institucioni i Avokatit të Populli, ka pranuar për shqyrtimit ankesën e shtetasit G.T, në të cilën është prezantuar shqetësimi i mosdorëzimit të shpërblimit, nga ana e Bashkisë, Fier, me rastin e shpronësimit të pasurisë së të ndjerit Vezir Troka, nr.6/26, vol 11, faqe 195, ZK 8533, të regjistrit të ZVRPP, Fier, në procesin e zbatimit të projektit të rikonstruksionit të Rrugës "Harrilla Bozo", Lagja 15 Tetori.

Në përgjigje të Kërkesës nr.K3/G28-2 Prot, datë 29.05.2017, të Institucionit të Avokatit të Populli, sipas të cilës është kërkuar informacion dhe shpjegime rreth shkaqeve të cilat justifikojnë mosdorëzimin e detyrimit në të holla, Bashkia, Fier, me shkresën nr.4742/1 Prot, datë 20.06.2016, bënë të ditur midis të tjerave se;

"... Bashkia, Fier, po rishikon edhe njëherë praktikën për të vlerësuar dokumentacionin e kërkuar në përputhje me legjislacionin dhe afatet kohore..."

Qëndrimi, sikurse shprehur, nuk mund të justifikoj cënimin e së drejtës të pronësisë së subjektit të shpronësuar (trashëgimtarëve të tij) për një periudhë 10-11 vjeçare me pretendimin e rishikimit edhe njëherë të praktikës për të vlerësuar dokumentacionin etj,

Referuar dokumentacionit të venë në dispozicion prej ankuesit, rezulton se, subjekti i shpronësuar është pajisur prej ZVRPP, Fier, si me Vërtetim "Nga dokumentet hipotekor" datë 05.04.2001, për pasurinë e regjistruar me numër 6/26, ZK 8533, truall me sipërfaqe 790m2, ashtu dhe me Çertifikatë "Për vërtetim pronësie", datë 22.02.2006, për pasurinë nr. 6/26, vol 11, faqe 195, ZK 8533, të regjistrit të ZVRPP, Fier. Pra, sikundër konstatohet, subjekti i shpronësuar ka disponuar dokumentacionin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm ligjor i cili ka detyruar dhe detyron Bashkinë, Fier, të dorëzoj vlerën e shpronësimit.

Në situatën e lartpërmendur, nuk konstatojmë ekzistencën e shkakut ligjor i cili do të mund të justifikonte mosdorëzimin e shpërbimit në favor të ankuesit, trashëgimtarëve të tij, nga ana e Bashkisë, Fier.

Ndodhur në kushtet kur pasuria e ankuesit, është e regjistruar në regjistrin e ZVRPP, Fier, nr.6/26, vol 11, faqe 195, ZK 8533, të regjistrit të ZVRPP, Fier, marrja në dorëzimin e saj për realizimin e projekteve, investimeve për ndërtimin e infrastrukturës publike kombëtare, do të mund të kryhej pas dorëzimit prej Bashkisë, Fier, të vlerës së shpronësimit.

Kjo procedurë, konstatohet e parespektuar prej Bashkisë, Fier, pasi prona e shpronësuar, i është hequr ankueses nga posedimi.

Ushtrimi i funksionit nga ana juaj, do të mundësojë respektimin e të drejtës së pronës, sikurse sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës, se:

“1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë”;

apo nenin 42, në të cilin sanksionohet se,

“1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

Gjithashtu, e drejta e pronës është e garantuar dhe nga parashikimi i kryer në nenin 1, të Protokollit nr.1, të Konvetës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, në të cilin parashikohet se;

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

Bashkia, Fier, në procesin e zbatimit të procedurave të shpronësimit ka cënuar dhe cënon parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor për shkak të mosdorëzimit të vlerës së shpronësimit pronarit të sendit, si dhe heqjes së posedimit pronarit mbi sendin e shpronësuar. Ky qëndrim, në vështirësi të parashikimeve të nenit 42/2 të Kushtetutës, se;

“...Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë

dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”,

apo nenin 6/1 të Konvetës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, nuk mund të vlerësohet i rregullt.

Për arsyet e bërë të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË

Mundësimin e dorëzimit sa më parë të shpërblimit, për pasurinë e shpronësuar të ndjerit V. T., regjistruar me nr.6/26, ZK 8533, të regjistrit të ZVRPP, Fier.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet kryer brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë;

Vërtetim “Nga dokumentet hipotekor” datë 05.04.2001, për pasurinë e regjistruar me numër 6/26, ZK 8533, truall me sipërfaqe 790m2, në emër të V.T, etj.

Çertifikatë “Për vërtetim pronësie”, datë 22.02.2006, për pasurinë nr. 6/26, vol 11, faqe 195, ZK 8533, të regjistrit të ZVRPP, Fier, lëshuar në favor të V.T, etj.

Kartelë e përshkrimit të pasurisë nr.6/26, vol 11, faqe 195, ZK 8533, lëshuar prej ZVRPP, Fier.

Harta e Regjistrimit të Pasurisë nr.6/26, vol 11, faqe 195, ZK 8533, lëshuar prej ZVRPP, Fier.

KOMISIONERI

Arben SHKEMBI